



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data
09.12.2020

NJOFTIM
Për thirrjen e mbledhjes së KOMISIONIT RREGULLATOR

Nr.
Protokolli

DREJTUAR: Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

224

E nderuar Kryetare e Rregullatorit,
Të nderuar anëtarë,

Në mbështetje të shkronjës "c", të paragrafit 1 të nenit 19 të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri vë në lëvizje Komisionin Rregullator sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tij.

Ju vë në dijeni, se është përgatitur projektvendimi "Caktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021".

Bazuar në shkronjën "a", paragrafi 2, të nenit 20 të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, miratimi i këtij projektvendimi është kompetencë e Komisionit Rregullator, për këtë arsye propozoj thirrjen e mbledhjes për shqyrtimin e këtij projektakti.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të projektvendimit dhe të relacionit shoqërues.

Materialet e mbledhjes ju vihen në dispozicion nga sekretaria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe mund t'i gjeni në faqen e KQZ-së në internet www.cec.org.al në rubrikën e Njoftimeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

